



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.8.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR
TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Ilir Abazi - Udhëheqës i ekipit të auditimit, me Anëtarët e ekipit Mirlinda Beqiri dhe Hysen Boqolli, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit -Bujar Sejdiu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	29
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	30
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	33
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 19/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Infrastrukturës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 1,113,189€ ishin buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga investimet kapitale; buxheti final në Pasqyrat Vjetore Financiare ishte i mbivlerësuar; si dhe vlera e pasurive dhe llogarive të arkëtueshme nuk është e saktë.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe ekipin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Ministrit

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Infrastrukturës (MI) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se PVF-të përmbajnë keq-klasifikim të shpenzimeve, gabime në buxhetin final dhe pasaktësi në vlerën e pasurive dhe llogarive të arkëtueshme si në vijim:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 1,113,189€ ishin buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Kjo ka ndodhur si pasojë e një planifikimi të gabuar të shpenzimeve në buxhetin e MI-së, e që pjesërisht ndikohet nga hartimi i buxhetit në nivel të MF-së;
- Buxheti final ishte mbivlerësuar për 295,078€ (prej tyre 195,078 për mallra dhe shërbime dhe 100,000€ për investime kapitale);
- Pasuritë janë mbivlerësuar për 1,113,189€, duke përfshirë blerjen e mallrat dhe shërbimeve për këtë vlerë, si dhe 110,548€ për shkak të mos zhvlerësimit të një pjese të pasurive. Për me tepër në PFV nuk ishte shpalosur vlera e stoqeve; dhe
- Vlera e llogarive të arkëtueshme ishte nënvlerësuar për 2,851,071€.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Infrastrukturës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Infrastrukturës kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga OB;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 06/2011;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit (MFK); dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike, etj.

Në kontekst të PFV-ve finale, përpos çështjeve të prezantuara të theksimi i çështjes të opinionit i auditimit, ne kemi identifikuar edhe disa gabime teknike në PFV si në vijim:

- Neni 13, pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme - totali i shfrytëzimit të fondeve është nënvlerësuar për shkak të gabimit teknik;
- Neni 14, raporti i ekzekutimit të buxhetit - te hyrja e parasë së gatshme gabimisht janë vendosur shumat e buxhetuara të huamarrjes nga Qeveria e Kosovës;
- Neni 14, raporti i ekzekutimit të buxhetit - totali i realizimit të shpenzimeve ishte mbivlerësuar për shkak të gabimit teknik ndonëse shumat sipas kategorive ishin prezantuar saktë;
- Në shënimin 4, shpenzimet komunale ishin nënvlerësuar; dhe
- Obligimet nuk janë shpalosur në detaje.

Të gjeturat më lartë reflektojnë mungesën e rishikimit kritik të PVF-ve nga menaxhmenti, i cili është i nevojshëm për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e tyre si dhe për të konfirmuar aplikimin e të gjitha kërkesave të tjera për raportim.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime që nuk kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar se:

- Raporti vjetor i performancës nuk është përgatitur nga MI;
- Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike (RVKNP), i raportuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), nuk është i plotë dhe i saktë sepse tri (3) aneks² kontrata në vlerë 509,126€ nuk janë prezantuar në këtë raport;
- Nuk janë ofruar dëshmi për raportimin e obligimeve të papaguara në MF/Thesar; dhe
- Vonesa në raportimin tremujor të detajuar për progresin e zbatimit të projekteve kapitale.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për dy (2) çështjet e sipërpërmendura me lartë ne japim rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë e mirëfilltë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i shmangur gabimet në klasifikimin e shpenzimeve, vlerësimin e pasurive dhe për të siguruar prezantim të drejtë të PVF-ve; dhe

Rekomandimi 2 Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe kërkesat për raportim të jashtëm. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

² Dy aneks kontrata për projektin Zgjerimi i rrugës nacionale N9-Segmenti Klinë-Pejë, lot 5 dhe lot 6, dhe aneks kontrata për projektin Vazhdimi i asfaltimit të rrugës lokale Botushë-Koshare.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore MI-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MI-së veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga MI, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen sa duhet në dëshmi. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit duhet të zhvillohen tutje. Menaxhmenti nuk ka dëshmuar proces të mirëfilltë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të monitorimit.

Në aspektin e pajtueshmërisë më legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë kryesisht prokurimin, kjo si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve të prokurimit dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga menaxhmenti, si dhe personelin, nga mos zbatimi i rregullave të shërbimit civil. Operimi i një sistemi adekuat për menaxhimin e pasurisë, obligimeve dhe llogarive të arkëtueshme ende nuk është vendosur.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ka rezultuar në 20 rekomandime kryesore. MI ka përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy (2) rekomandime janë zbatuar, tetë (8) janë në proces të zbatimit, ndërsa dhjetë (10) nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit të kaluar duke përfshirë klasifikimin e shpenzimeve, prokurimin, menaxhimin e pasurisë dhe obligimeve nuk janë zbatuar sepse MI nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP). Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim të identifikohen dhe adresohen. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjithë organizatën.
- Rreziku** Përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale dhe të tjera mund të mos implementohen duke rezultuar me jo efikasitet të vazhdueshëm organizativ, vlerë e dobët për para në praktikën e prokurimit dhe humbje potenciale financiare.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara.

2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të ZKM-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MI-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 4 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga MI nuk është kuptuar sa duhet dhe në disa raste përgjigjet e dhëna nuk kishin prezantuar gjendjen reale të ministrisë. Vlerësimi me notë është mbivlerësuar për disa pjesë në kuadër të komponentëve të MFK-së;
2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohen si të vendosura nga menaxhmenti, mirëpo dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve janë të pamjaftueshme;
3. Menaxhimi i rrezikut në kuadër të MFK-së ende mbetet i pa adresuar ndonëse ekzistojnë aktivitete në procesin e menaxhimit të rrezikut në fushën teknike të transportit dhe komunikacionit rrugor. Kjo reflekton mungesën e kuptimit të rëndësisë së menaxhimit të rrezikut për fushat financiare dhe operative të Ministrisë; dhe
4. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga MI dhe dëshmitë deri diku e mbështesin këtë konkluzion, mirëpo cilësia e raporteve dhe analizimi i çështjeve financiare duhet të avancohen më tutje. Çështjet e raportimit dhe monitorimit po ashtu janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.5.2

Veprimi i ndërmarrë nga menaxhmenti për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vet-vlerësimi i vitit 2015 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda MI-së lidhur me rëndësinë e këtij pyetësi dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 4

Ministri duhet të sigurojë se është analizuar plotësimi i pyetësit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Rëndësi e veçante t'i kushtohet avancimit të mëtutjeshëm të procesit të menaxhimit të rrezikut, përfshirë tij aspektet tjera të fushë veprimtarisë së ministrisë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MI operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin implementimin e planeve strategjike në nivel të organizatës. Rregullat dhe udhëzimet e MFK-së përcaktojnë kërkesat dhe përgjegjësitë e organizatave për hartimin e planeve strategjike dhe përcaktimin e objektivave të organizatës.

Çështja 5 – Mungesa e planit strategjik të Ministrisë – Prioritet i lartë

- E gjetura** MI ende nuk ka hartuar një plan strategjik. Është përgatitur një dokument i veçantë për strategjinë sektoriale dhe transportit multimodal 2015-2025 dhe planin e veprimit 5 vjeçar, por jo një plan strategjik në nivel të përgjithshëm të Ministrisë, në të cilën do të përcaktoheshin objektivat strategjike të organizatës, përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e atij plani, si dhe llogaritjen e kostos së realizimit të strategjisë.
- Rreziku** Mungesa e planit strategjik pamundëson përmbushjen efektive të objektivave në pikëpamje të vizionit të ministrisë si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë. Kjo pamundëson edhe zhvillimin e një procesi të mirëfilltë të menaxhimit të rrezikut për shkak të ndërlidhje me objektivat e përcaktuara me planin strategjik.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të ndërmarrë hapa konkret drejt procesit të hartimit të planit strategjik dhe vendosjes së objektivave të ministrisë, si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.

2.3.2 Raportimi menaxherial

Menaxhmenti duhet të zbatojë një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare dhe ato të kontrollit funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Menaxhmenti i ministrisë ka vendosur linja të komunikimit, dhe se njoftohet përmes raportimeve për aktivitetet operacionale dhe financiare të organizatës.

Çështja 6 – Dobësi në raportimin menaxherial – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Edhe pse ekziston procesi i raportimit të brendshëm, formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth ndryshimeve në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Kjo reflekton një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Ngjashëm, synimet operative nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.
- Rreziku** Cilësia jo e mirë e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet ministrisë në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo gjithashtu mund të bëjë që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve jo cilësore.
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të vendosur një format të përshtatshëm të raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, si dhe ngritjen e cilësisë së informacionit që pranojnë për të mbështetur menaxhimin efektiv të veprimtarisë së ministrisë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër (4) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe tre (3) auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MI-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruara nga një Komitet i Auditimit efektiv.

Çështja 7 – Sistemi i Auditimit të Brendshëm – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Ekzistojnë disa çështje në lidhje me sistemin e auditimit të brendshëm:

- Nuk ka pasur auditim në fushën e buxhetit dhe financave/shpenzimeve, listat e pagave dhe menaxhimin e pasurisë, ndonëse ishin planifikuar me planin vjetor të auditimit;
- Menaxhimi i të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme nuk ishte përfshirë në planin vjetor të auditimit;
- Rekomandimet e auditimit të brendshëm për nivelin menaxherial nuk janë zbatuar; dhe
- Një anëtar i komitetit të auditimit (KA) ishte pjesë e divizionit për buxhet e financa (shefe e sektorit të financave) e që parqet praktikë jo të mirë për përbërjen e këtij komiteti.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën gatishmërisë së menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontroleve të brendshme. Kjo gjithashtu tregon për nevojën e një planifikimi dhe menaxhimi më të mirë të planit të auditimit të brendshëm.

Rreziku

Një program jo i plotë i auditimit i cili nuk përfshin rreziqet e hasura në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve ndikon në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive në kontrole duke rezultuar në jo efikasitet operativ dhe humbje financiare. Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm do të vazhdojë përsëritjen e mëtutjeshme të dobësive. KA me anëtar nga ekzekutivi mund të mos jetë objektiv në trajtimin çështjeve të ngritura rreth aktiviteteve të ekzekutivit në raportet e auditimit të brendshëm.

Rekomandimi 7

Ministri duhet të sigurojë se plani vjetor i auditimit është më gjithëpërfshirës, i bazuar në rrezik, dhe implementohet në tërësi nga NjAB. KA duhet të jetë më objektiv, të sigurohet se përbërja e anëtarëve të komitetit të mos përfshijë personel që janë të angazhuar në punët ekzekutive nga fusha e buxhetit dhe financave. Gjithashtu të rishikohen veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në OB. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit, prokurimi edhe më tutje mbetet fushë për përmirësim. Kjo ngase nuk janë duke u zbatuar si duhet rregulloret, por edhe mungesës së mbikëqyrjes së duhur nga menaxhmenti, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para dhe shërbime jo efikase për qytetarët dhe shfrytëzuesit e tjerë. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: planifikimi buxhetor, menaxhimi i projekteve kapitale, menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, si dhe menaxhimi i obligimeve dhe pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e realizuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat	1,785,000	1,785,000	2,510,869	1,885,177	2,254,322
Totali	1,785,000	1,785,000	2,510,869	1,885,177	2,254,322

Të hyrat e inkasuara nuk shpenzoheshin për nevojat e MI, por transferohen në Buxhetin e Kosovës (BK).

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	182,956,552	238,578,506	213,025,342	166,658,872	158,929,930
Granti i Qeverisë - Buxheti	168,256,552	214,337,965	213,025,342	166,658,872	158,929,930
Financimet nga Huamarrjet	14,700,000	24,240,541	-	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 55,621,954€. Rritja e buxhetit kryesisht i takon kategorisë së investimeve kapitale dhe vetëm 80,109€ mallrave dhe shërbimeve. Kjo rritje është aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2016, MI ka përdorur 89% të buxhet final ose 213,025,342€, me një përmirësim prej 5% krahasuar me vitin 2015. Me gjithë trendin pozitiv, realizimi i buxhetit në disa kategori buxhetore mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenz. e fondeve sipas kategorive ekonomike:	182,956,552	238,578,506	213,025,342	166,658,872	158,929,930
Pagat dhe Mëditjet	1,808,393	1,755,715	1,716,303	1,509,799	1,413,642
Mallrat dhe Shërbimet	5,903,323	5,983,432	5,883,302	5,794,374	5,086,963
Shërbimet komunale	375,190	375,190	153,637	180,489	182,143
Subvencionet e Transferet	1,443,814	832,678	832,678	1,012,234	1,495,961
Investimet Kapitale	173,425,832	229,631,491	204,439,421	158,161,976	150,751,221

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga e mëditje nuk ishte realizuar sipas planit fillestar sepse nuk ishin plotësuar të gjitha pozitat e lejuara. Si rezultat, Qeveria ka zvogëluar buxhetin e ndarë për këtë kategori për 52,678€;
- Buxheti për mallra dhe shërbime është rritur me vendim të Qeverisë për 80,109€, si rezultat i nevojave shtesë për mallra dhe shërbime;

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

-
- Buxheti për subvencione dhe transfere është zvogëluar për 611,136€. Qeveria ka zvogëluar buxhetin e kësaj kategorie, meqë MI nuk ka arritë të kontraktojë me kohë financimin e shërbimeve të transportit rrugor; dhe
 - Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale për 56,205,659€, vetëm 89% e buxhetit ishte shpenzuar. Rritja buxhetore kryesisht është dedikuar për projektin e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit (R6) në vlerë 50,000,000€ si dhe disa projekte tjera për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve si dhe për projektet e bashkëfinancimit me komunat e Kosovës. Financimi nga huamarrja për projektin e zgjerimit dhe rehabilitimin e rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, në vlerë 14,700,000€ nuk është realizuar gjatë vitit 2016.
-

Çështja 8 – Realizim jo i mirë i buxhetit për investime kapitale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Buxheti për investime kapitale nuk ishte realizuar në nivelin e pritur. Suficiti buxhetor i kësaj kategorie në fund të vitit ishte 25,192,070€, përderisa në anën tjetër obligimet e pa paguara për investime kapitale ishin 15,289,020€.
- Rreziku** Planifikimi i dobët dhe realizimi i ulët i buxhetit shkakton ngecje në përmbushjen dhe efektivitetin e planeve dhe mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2016 ishin në vlerë 2,510,869. Ato kanë të bëjnë me taksat për patent shofer, licencat për transport, leje për qasje në rrugë, dhe taksa tjera administrative.

Tabela.4 Të hyrat e realizuara sipas llojit (në €)

Kodi Ekonomik	Lloji i të hyrës	Realizimi 2016
5005	Taksa për leje të vozitjes	1,847,280
50019	Taksa tjera administrative	169,618
50107	Gjobat tjera	12,500
50201	Licenca për aktiv. individ. dhe të lira	103,184
50208	Licenca për transport të mallrave	90,315
50290	Licenca tjera për afarizëm	222,675
50401	Shitja e shërbimeve	41,171
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	12,240
50413	Të hyrat nga shitja e pasurisë	11,901
55300	Pranimet tjera	(15)
Totali		2,510,869

Të hyrat e mbledhura nuk shfrytëzohen nga MI, por transferohen në Buxhetin e Kosovës. Pjesa më e madhe e të hyrave të realizuara i takojnë taksave për leje të vozitjes. Të hyrat janë regjistruar me kohë dhe klasifikuar në kode përkatëse ekonomike, dhe se janë bërë harmonizime të rregullta mujore me MF/Thesar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Në fund të vitit MI kishte 294 të punësuar nga 296 sa ishin aprovuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2016. Kontrollat e zbatuara nga menaxhmenti konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave. Njësia e personelit aplikon sistemin informativ të menaxhimit të burimeve njerëzore (SIMBNj) përmes së cilës menaxhon informatat për secilën dosje të personelit.

Çështja 9 – Tejkalimet e afateve të përcaktuara kohore për marrëveshjet për shërbime të veçanta – Prioritet i mesëm

E gjetura Testimet e bëra tregojnë se menaxhmenti nuk i ka zbatuar kontrollet ekzistuese në mënyrë efektive për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret relevante. MI kishte angazhuar 61 punonjës përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta dhe në të gjitha rastet kohëzgjatja e marrëveshjeve kishte tejkaluar afatin e lejuar kohor prej gjashtë (6) muajsh. Mungonin edhe dëshmitë e mjaftueshme rreth nevojave dhe arsyeshmërisë së aplikimit të kësaj forme të angazhimit të punonjësve.

Rreziku Niveli i lartë i punonjësve me marrëveshje për shërbime të veçanta mund të rezultojë me performancë të ulët sepse punët mund të mos realizohen me kompetencë dhe profesionalizëm. Kjo po ashtu rezulton me vlerë të ulët për paratë e shpenzuar.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për ta adresuar, si çështje urgjente, angazhimin e punonjësve me marrëveshje për shërbime të veçanta. Kjo formë e kontraktimit të bëhet vetëm në raste të veçanta dhe të arsyeshme për nga aspekti kohor dhe i nevojave të angazhimit.

Çështja 10 – Dobësi në menaxhimin e personelit – Prioritet i mesëm

E gjetura Testimet në fushën e menaxhimit të personelit konfirmuan mos harmonizime në emërtimin e pozitave në mes listës së pagave/payroll dhe akt emërimeve, ndërsa në katër (4) dosje të shqyrtuara kishte mungesë të dokumentacionit. Në dy departamente, numri i personelit ishte tejkaluar nga numri i aprovuar me ligjin e buxhetit, por duke mos e tejkaluar në total numrin e përgjithshëm të aprovuar nga Kuvendi. Po ashtu, MI kishte 19 pozita udhëheqëse me Ushtrues Detyre (UD) për më gjatë se tre (3) muaj. Pozitat me UD vazhdojnë të mbahen që nga viti 2015 e tutje.

Rreziku Çështjet e identifikuara mund të vështirësojnë menaxhimin e duhur të personelit. Mbajtja e pozitave me UD për një kohë të gjatë nuk siguron se detyrat po menaxhohen me përgjegjësi dhe kompetencë të plotë.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë se menaxhimi i personelit bëhet në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante për shërbimin civil. Po ashtu për pozitat me UD duhet të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme në pajtim me kornizën ligjore.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë edhe ato komunale në vitin 2016 ishte 6,358,622€. Prej tyre ishin shpenzuar 6,036,940€, ose 95%. Pjesa më e madhe e buxhetit për mallra dhe shërbime është dedikuar për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale të vendit.

Çështja 11 - Dobësi në procedurat e prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura

Ekzistojnë një numër dobësish në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit si pasojë e mos zbatimit të kontrolleve, ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve të prokurimit publik. Testimet tona kanë identifikuar mangësitë në vijim:

- Te procedura e prokurimit “Furnizim me veshmbathje verore dhe dimërore” në vlerë 8,430€, kontrata fillimisht ishte nënshkruar para zotimit të mjeteve, më pastaj, e njëjta kontratë ishte ri nënshkruar pas datës së zotimit të mjeteve. Po ashtu Operatori Ekonomik (OE) fitues i tenderit nuk kishte ofruar vërtetimin tatimor, vërtetimin nga gjykata dhe deklaratën për specifikimet teknike të furnizimeve; raporti i vlerësimit të tenderëve nuk ishte nënshkruar nga udhëheqësi i prokurimit; cilësia e furnizimeve ishte kontestuar nga njëri prej anëtarëve të komisionit vlerësues; dhe nuk ishte aplikuar plani i menaxhimit të kontratës (PMK);
- Te procedura e prokurimit “Shërbime gjeodezike për përpilimin e elaborateve në shpronësimin për rrugët nacionale, magjistrale dhe regjionale të Kosovës” në vlerë të parashikuar prej 90,000€, fituesi i tenderit nuk kishte përmbushur kriteret e dosjes së tenderit. OE fitues nuk kishte ofruar vërtetimin tatimor, vërtetimin nga gjykata dhe as dëshmi të mjaftueshme për kontratat, përvojën e personelit, licencën dhe diplomën e menaxherit të projektit. Për më tepër, çmimi i ofertës ishte 48.97€ që paraqet një çmim jo normalisht të ulët në krahasim me ofertat tjera ku çmimi varionte nga 258.56€ deri 564.04€ ndërsa çmimi i parashikuar nga njësia kërkuese ishte 698.68€. MI nuk kishte zbatuar kërkesat ligjore për rastet e tilla dhe nuk na ka ofruar ndonjë shpjegim lidhur me këtë situatë. Po ashtu menaxheri i kontratës ishte caktuar me një (1) muaj vonesë, ndërsa PMK ishte nënshkruar një (1) muaj pas caktimit të menaxherit;
- Te procedura e prokurimit “Marrja e 16 veturave me qira për nevojat e MI-së” në vlerë 79,104€, anëtar i komisionit të vlerësimit ishte zyrtari që ishte përfshirë në përgatitjen e specifikave teknike, si dhe raporti i vlerësimit të tenderit nuk ishte nënshkruar nga menaxheri i prokurimit. Buxheti i kësaj kontrate ishte regjistruar gabimisht në kodin ‘shërbime kontraktuese tjera’ e jo në kodin ‘qiraja për makineri’;

- Te procedura e prokurimit “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve - Lot-1”, me çmimin për njësi 11,323€, anëtar i komisionit të vlerësimit ishte zyrtari që ishte përfshirë në përgatitjen e specifikacionit teknik të dosjes së tenderit; dhe
- Kontrata “Servisimi i kompjuterëve dhe llaptopëve” në vlerë 9,998€ ishte nënshkruar me tre (3) muaj vonesë dhe sigurimi i ekzekutimit nuk kishte mbuluar periudhën e kontratës. Gjithashtu në këtë lëndë mungonte zotimi i mjeteve, letër informimi për tenderuesit e pasuksesshëm, njoftimi për nënshkrim të kontratës, PMK si dhe nënshkrimi i deklaratës nën betim nga njëri prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit.

Rreziku

Mos zbatimi i drejtë i rregullave dhe udhëzuesve të prokurimit publik mund të rezultojë në përzgjedhjen e ofertuesve të papërgjegjshëm, shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të tenderuesve dhe vlerë të dobët për para në praktikat e prokurimit.

Rekomandimi 11

Ministri duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim gjithëpërfshirës për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit publik nuk janë zbatuar në tërësi. Kontrollat e brendshme në këtë fushë duhet të jenë subjekt i rishikimit urgjent nga menaxhmenti. Në prokurimet e radhës duhet të aplikohen kontrolle efektive që sigurojnë pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore në të gjitha fazat e procesit të prokurimit.

Çështja 12 – Dobësi në menaxhimin e kontratave – Prioritet i mesëm**E gjetura**

Testimet tona kanë identifikuar disa dobësi në menaxhimin e kontratave si në vijim:

- Në tri (3) kontrata të mirëmbajtjes së rrugëve kohëzgjatja e sigurimit të ekzekutimit nuk ishte në afatin e duhur e as në vlerën e parashikuar të kontratave publike kornizë;
- Në katër (4) raste raportet e pranimit të mallrave/shërbimeve të hartuara nga menaxherët e kontratave (MK) nuk ishin në formatin standard të PMK-së;
- Në dy (2) kontrata për mirëmbajtje të rrugëve, ndalesat/mbajtjet për 10% të pagesave për secilin situacion ishin liruar pa u përfunduar punimet, ndërsa në dy (2) raste tjera nuk ishin aplikuar penalet për vonesat në realizimin e punimeve; dhe

- Në dy (2) raste urdhërblertet ishin nënshkruar pas pranimit të faturës, ndërsa në një (1) rast urdhërblertja nuk ishte nënshkruar nga menaxheri i kontratës.

Rreziku

Menaxhimi i dobët i kontratave mund të ndikojë në mos zbatimin e kontratave sipas kushteve kontraktuale, redukton efektivitetin në arritjen e objektivave dhe mund të rezultojë me vlerë të ulët për para dhe pagesa potencialisht të parregullta.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim rreth dobësive të identifikuarra, si dhe të analizojë pse nuk është aplikuar mbikëqyrja efektive e menaxhimit të kontratave. Kontrolltet duhet të forcohen për të siguruar që menaxhimi i kontratave zhvillohet sipas kërkesave dhe udhëzuesve përkatëse.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 832,678€, të cilat ishin realizuar në tërësi. Ato kanë të bëjnë me financimin e transportit rrugor nëpër linjat e paqëndrueshme të transportit rrugor si dhe mbështetja dhe financimi i biletave të udhëtarëve në linjat hekurudhore funksionale.

Çështja 13 – Vonesa në vlerësimin e ofertave - Prioritet i mesëm**E gjetura**

MI përmes subvencioneve siguron transportin humanitar të udhëtarëve, kryesisht të komuniteteve, nëpër linjat e paqëndrueshme të transportit rrugor. Një prej këtyre aktiviteteve MI e kishte kryer përmes një kontrate për "Transportin Humanitar – Lot 20" në vlerë 18,622€. Aktiviteti i prokurimit të këtij shërbimi ishte përcjellë me ankesë të OE, për të cilën OSHP kishte vendosur që lënda të kthehet në rivlerësim nga MI. Procesi i rivlerësimit të ofertave ishte vonuar dy (2) muaj ndërsa njoftimi për dhënie të kontratës është publikuar dy (2) javë pas rivlerësimit. Kontrata ishte nënshkruar rreth dy (2) muaj pas njoftimit për dhënie të kontratës. Tërë procesi deri te nënshkrimi i kontratës ka zgjatur rreth një (1) vit. Për më tepër, auditimi ynë ka identifikuar edhe papajtueshmëri tjera si: mungesa e sigurisë së ekzekutimit të kontratës, mos nënshkrimi i raportit të vlerësimit nga drejtori i prokurimit dhe mos njoftimi në KRPP për nënshkrimin e kontratës.

Rreziku

Dobësitë e identifikuarra tregojnë një mungesë të kontroleve në shpenzimin e buxhetit për subvencione. Vonesat e gjata në proceset e lartcekura mund të jenë subjekt i shmangieve nga kërkesat e rregulloreve dhe si të tilla ndikojnë negativisht në realizimin e planeve brenda afateve të përcaktuara dhe në vështirësimin e jetës së qytetarëve të targetuar.

Rekomandimi 13 Ministri duhet t'i analizojë arsyet e dështimit të kontrolleve dhe të identifikojë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në realizimin e projekteve. Një dizajn i kontrolleve efektive, në pajtueshmëri të plotë me rregulloret, duhet të sigurohet dhe të monitorohet në mënyrë sistematike nga ana e menaxhmentit.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 229,631,491€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 204,439,421€ apo 89% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me investimet në infrastrukturën rrugore, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve. Në buxhetin e rishikuar për vitin 2016 ishin planifikuar 159 projekte kapitale prej të cilave 104 ishin projekte të reja ndërsa 54 ishin vazhdim i projekteve nga vitet paraprake.

Çështja 14 – Menaxhimi i projekteve kapitale – Prioritet i lartë

E gjetura Nga rishikimi analitik i realizimit të projekteve kapitale kemi identifikuar se:

- 59 projekte në vlerë totale 5,197,949€, nga të cilat 55 të reja dhe katër (4) vazhdim nga vitet paraprake, nuk kishin fare realizim respektivisht progres financiar;
- 36 projekte, nga të cilat 15 të reja dhe 21 vazhdim nga vitet paraprake, kishin tejkaluar parashikimet e fondeve në buxhetin e rishikuar në vlerë 23,979,728€; dhe
- Tetë (8) projekte në vlerë totale 19,558,856€, nga të cilat katër (4) të reja dhe katër (4) vazhdim nga vitet paraprake, ishin realizuar në nivel më të ulët se 40% krahasuar me planifikimin buxhetor.

Këto ngecje në realizimin e projekteve kanë ndodhur për shkak të dobësive në planifikim dhe menaxhim të projekteve dhe kontrolleve të dobëta buxhetore.

Rreziku Realizimi i dobët i projekteve kapitale rezulton në mos arritjen e objektivave vjetore dhe strategjike të ministrisë dhe shkurtime potenciale të fondeve për periudhat e ardhshme dhe/apo mbulimin e detyrimeve me fondet e viteve të ardhshme.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të sigurojë që planifikimi i projekteve i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen për të tejkaluar sfidat e identifikuara me qëllim të arritjes së objektivave të ministrisë brenda afateve kohore. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale.

Çështja 15 - Dobësitë në prokurim - Prioritet i lartë**E gjetura**

Auditimi ynë në procesin e prokurimit ka identifikuar dobësitë në vijim:

- Te procedura e prokurimit “Ndërtimi i rrugës Prelez i Jerlive - Muhovc - Lloshkobare - Ferizaj” në vlerë 689,454€, OE fitues nuk kishte përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit. OE nuk kishte ofruar vërtetimin nga gjykata, ndërsa vërtetimi tatimor përveç që ishte jo valid (me afat të skaduar) dëshmonte se biznesi kishte borxhe të pa paguara. Vërtetim jo valid kishte ofruar edhe OE fitues i kontratës “Zgjerimi i rrugës N25 Suharekë-Korishë” në vlerë 689,454€;
- Për kontratën “Rehabilitimin e Rrugës Kramovik-Xërxë” në vlerë 487,498€, siguria e ekzekutimit nuk ishte valide për periudhën e kërkuar. Ngjashëm, për kontratën “Asfaltimi i rrugës qe lidh fshatin Koshtovë me N2 Mitrovice” në vlerë 211,075€, siguria e ekzekutimit nuk kishte përfshirë edhe periudhën 30 ditëshe pas përfundimit të kontratës; dhe
- MI kishte nënshkruar kontratë për projektin “Asfaltimi i rrugës Dol-Kusar- Goden-faza e dytë”, në vlerë 799,650€, përkundër faktit që me deklaratën e disponueshmërisë së fondeve shuma e ndarë buxhetore për vitin 2016 ishte e dedikuar për përmbushjen e obligimeve të mbetura nga një kontratë tjetër për fazën e parë të këtij projekti.

Rreziku

Dështimet për të përmbushur kërkesat ligjore në blerjet përmes procedurave të prokurimit mund të rezultojnë në përzgjedhjen e ofertuesve të papërgjegjshëm. Kjo rrezikon parimin e trajtimit të barabartë dhe vlerës për para si dhe redukton efektivitetin e planeve të MI-së dhe vështirëson implementimin e projekteve.

Rekomandimi 15

Ministri i duhet t'i analizojë arsyet e papajtueshmërive të identifikuara dhe t'i forcojë kontrollet e prokurimit për të siguruar që të gjitha kërkesat ligjore do të përmbushen. Vetëm operatorët që përmbushin në tërësi kërkesat e përcaktuara duhet të shpërblehen me kontratë për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret dhe vlerë të duhur për paranë e shpenzuar .

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë paraqitur çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale.

Çështja 16 – Mos ofrimi i informatave të plota për auditim – Prioritet i lartë

E gjetura Në mesin e lëndëve që ishin subjekt i auditimit tonë për vitin 2016 ishin edhe tri (3) dosje të kontratave për mallra dhe shërbime dhe një (1) për investime kapitale të cilat nuk ishin të kompletuara me ofertat e fituesve dhe me disa informacione rreth procedurave administrative të aktivitetit të prokurimit. Dosjet e pakompletuara ishin për kontratat në vijim:

1. Asfaltimi i rrugës Dol-Kusar-Gogen-Gjakovë, në vlerë 799,650€;
2. Marrja e 16 veturave me qira për nevojat e MI-së, në vlerë 79,104€;
3. Servisimi i automjeteve të MI-së, në vlerë 11,324€ (çmim për njësi); dhe
4. Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së kompjuterëve dhe llaptopëve, në vlerë 998€ (çmim për njësi).

Përkundër kërkesës sonë të vazhdueshme, Zyra e Prokurimit nuk na ka ofruar dosjet e plota me arsyetimin që nuk mund t'i gjejnë.

Po ashtu një dosje tjetër e prokurimit në vlerë 963,409€ nuk është ofruar për auditim. Sipas zyrtarëve të prokurimit kjo lëndë është marrë në shqyrtim nga Agjencia Kundër Korrupsionit por, edhe pas kërkesës sonë, për këtë nuk na është ofruar ndonjë dëshmi.

Rreziku Mos ofrimi i të gjitha informatave/dokumenteve të kërkuara për auditim është në kundërshtim me legjislacionin⁴ dhe mund të jetë subjekt i sanksionimit. Për më tepër, pamundësia e MI-së për gjetjen e dokumenteve redukton aftësinë e menaxhmentit për monitorim dhe vendimmarrje efektive dhe vë në dyshim pajtueshmërinë ligjore të procesit të prokurimit publik.

Rekomandimi 16 Ministri duhet t'i rishikojë proceset e arkivimit, ruajtjes dhe sistemimit të dokumenteve dhe t'i identifikojë arsyet për mos ofrimin e informatave të plota për auditim. Ministri duhet t'i përforcojë mekanizmat e kontrollit dhe të kërkojë llogaridhënie nga zyrtarët e prokurimit për të siguruar që situatat e tilla mos të përsëriten në ardhmen.

⁴ Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 1/2016 për zbatimin e të drejtave dhe përgjegjësisive të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe entiteteve të audituara.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Bazuar në shpalosjet e pasurisë në PVF-të e vitit 2016 dhe sipas regjistrit kontabël në SIMFK vlera neto e pasurisë kapitale të MI-së ishte 1,224,724,436€, ndërsa vlera neto e pasurisë jokapitale e regjistruar në sistemin qeveritar e-pasuria ishte 373,141€. Në fund të vitit MI kishte bërë inventarizimi dhe vlerësimin e pasurisë jo financiare.

Çështjet në menaxhimin e pasurive si mbivlerësimi, mos zhvlerësimi dhe mungesa e shpalosjeve të stoqeve janë prezantuar në Kapitullin 1 të këtij raporti.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme apo të hyrat e painkasura kanë të bëjnë me kryesisht nga taksat që operatorët ekonomik duhet të paguajnë për shfrytëzimin e brezit rrugor përkatësisht kycjes në rrugë, taksave për transport të jashtëzakonshëm, etj.

Çështja 17 - Menaxhim jo i mirë i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

- E gjetura** Auditimi ynë ka identifikuar që llogaritë e arkëtueshme nuk janë menaxhuar në mënyrë adekuate nga MI. Një pjesë e llogarive të arkëtueshmet datojnë që nga viti 2000, ndërsa menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme dhe efektive për inkasimin e tyre. Kjo ka ndodhur për shkak se MI nuk ka hartuar ndonjë udhëzim ose procedurë të brendshme për menaxhimin e të arkëtueshmeve. Në fund të vitit 2016 vlera e këtyre llogarive arrinte në 3,077,305€. Nënvlërësimi i tyre në PVF-të e vitit 2016 është trajtuar te nënkapitulli 1.2 i këtij raporti.
- Rreziku** Një menaxhim jo i duhur i llogarive të arkëtueshme dhe mungesa e veprimeve efektive në mbledhjen e tyre rezulton në burime të reduktuara për Buxhetin e Kosovës. Vonesa në inkasimin e këtyre llogarive mund të shpie në një situatë ku inkasimi është i pamundshëm.
- Rekomandimi 17** Ministri duhet t'i identifikojë barrierat në inkasimin e të arkëtueshmeve dhe të sigurojë mekanizma efektive, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar se faturat e debitorëve janë paguar apo janë duke u adresuar. Krahas kësaj, duhet të vendosen kontrole efektive për të parandaluar ngritjen e mëtutjeshme të këtyre llogarive.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 15,535,336€. Pothuajse tërë detyrimet i takojnë kategorisë së investimeve kapitale, ndërsa vetëm 246,316€ u takojnë subvencioneve dhe transfereve si dhe kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Përveç kësaj, MI është e ekspozuar edhe ndaj detyrimeve kontingjente, të cilat janë vlerësuar të jenë 14,407,675€.

Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të sfidës në menaxhimin buxhetor nga MI dhe është shqyrtuar më në detaje në nënkapitullin 3.3. Për me tepër ne kemi shpalosur parregullsitë në vijim.

Çështja 18 - Menaxhimi jo i mirë i obligimeve - Prioritet i lartë

- E gjetura** Për shkak të menaxhimit të dobët obligimet e MI-së kanë arritur vlerë relativisht të lartë. Një suficit që tejkalon vlerën e këtyre obligimeve tregon për dobësi në menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit dhe qasje jo të duhur kundrejt obligimeve. Bartja për pagesë në vitin vijues rëndon tutje buxhetin e MI-së për vitin 2017. Kjo ka ndodhur për shkak të mosrespektimit të rregulloreve për pagesën e faturave në afatin e përcaktuar ligjor. Testimet tona kanë evidentuar 14 raste të vonesave në pagesën e faturave. Në anën tjetër, përveç për muajt gusht dhe shtator, MI nuk ka ofruar dëshmi për raportimet mujore të obligimeve në MF.
- Rreziku** Niveli i lartë i obligimeve (përfshirë ato kontingjente) shton rrezikun që buxheti i MI-së të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore. Një situatë e tillë mund të rezultojë me vështirësi financiare dhe/apo mosrealizimin e projekteve dhe sfida në financimin e aktiviteteve kryesore. Në anën tjetër, mos raportimi i obligimeve i pamundëson Qeverisë të ketë informacionin e duhur dhe në kohë për nivelin e Borxhit Publik.
- Rekomandimi 18** Ministri duhet t'i forcojë kontrollet menaxheriale duke siguruar një planifikim të hollësishëm të buxhetit dhe shfrytëzim të fondeve të bazuar në një plan të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Ministri poashtu duhet të paraqes një plan ku parashihet buxheti dhe veprimet konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të akumuluar. Ky plan duhet të monitorohet direkt nga menaxhmenti. Në anën tjetër, të gjitha obligimet duhet të raportohen me kohë në MF/Thesar.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Rreziqet domethënëse në PVF	Ministri duhet të konsideroj çështjen e shpenzimeve lidhur me mirëmbajtjen investive të rrugëve, dhe të analizoj çështjen me rastin e ndarjeve buxhetore me qëllim që të mundësohet një ndarje e drejtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike. Në anën tjetër të siguroj se është duke u zbatuar një proces i cili do të mundësonte evidentimin e plotë të pasurisë në regjistrat e saj dhe siguron vlerësim të drejtë të pasurisë në PVF 2016. Ky proces duhet të përmirësoj trajtimet kontabël lidhur me bashkëfinancimet dhe të siguroj se çdo lëvizje apo shpërndarje e pasurisë të jetë saktësisht e dokumentuar. Të gjitha projektet kapitale të financuara nga Ministria si bashkë financuese të vazhdojnë të evidentohen si investime në vijim, të shoqëruar me një plan me detajet dhe datat e transferit, përfituesit, kostos, etj. Po ashtu, të sigurohet se menaxhimi i stoqeve të kripës ka raporte të sakta mbi furnizimin dhe shpërndarjen e saj. Ky proces duhet të përcaktoj saktë bilancin për sasinë dhe vlerën në fund të vitit.			Nuk janë marrë masa.
1.4 PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.

2.3 Adresimi i rekomandimeve	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Në proces të zbatimit.	
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së.	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Në proces të zbatimit.	
2.5.1 Vendosja e objektivave strategjike	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë hapa drejt vendosjes së objektivave dhe se janë ndërmarrë aranzhimet përkatëse për hartimin e planit strategjik.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Vlerësimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		Në proces të zbatimit.	
2.5.3 Raportimi menaxherial	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2016.			Nuk janë marrë masa.
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitim të maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.		Në proces të zbatimit.	

3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që gjatë procesit të buxhetimit shpenzimet e buxhetuara të klasifikohen sipas planit kontabël.			Rekomandim i pazbatuar.
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë që një sistem i prokurimit është funksional, marrë parasysh në këtë rast emërimin e komisioneve adekuate dhe monitorimi i aktivitetit të prokurimit nga ana e zyrtarit përgjegjës. Njëkohësisht Ministri të sigurojë se ka raportime të rregullta nga departamenti i prokurimit lidhur me ankesat e OE-ve duke paraqitur edhe shkaqet për parandalimin e dobësive të paraqitura dhe vonesave në procedura. Rrjedhimisht, duhet të vendosen kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuara janë adresuar.		Në proces të zbatimit.	
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë që kontrolli në prokurim është efikas duke u fokusuar në fillimin e zbatimit të projekteve, të evidentoj shkaqet e mos realizimit të projekteve sipas dinamikës së paraparë dhe të procedoj të gjitha pagesat sipas afateve të caktuara kohore.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj që me rastin e dhënies së kontratës të bëhet njoftimi i duhur ndaj të gjithë OE-ve konkurrues, me qëllim të një procesi prokurimi të drejtë dhe transparent, dhe që të reflektoj ndaj një konkurrence të barabartë.		Në proces të zbatimit.	
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj se zyra e prokurimit ka një listë të OE-ve të cilët janë të përgjegjshëm ndaj realizimit të kontratave dhe ti shmangë kontratat e reja me ta. Në anën tjetër, të siguroj se procesi i blerjeve përmes prokurimit është i rregullt dhe të sigurojë që të gjitha informatat e kërkuara nga prokurimi janë në dispozicion.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen kontrole të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme.		Në proces të zbatimit.	

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të siguroj se kontrollet lidhur me menaxhimin e avanseve janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Ndërkohë, të siguroj se janë ndërmarrë masa për se të gjitha avancet janë mbyllur sipas kërkesave ligjore.			Nuk janë marrë masa.
3.5.2 Kompensimet	Ministri duhet të konsideroj që me rastin e planifikimit të buxhetit, të parasheh nevojat e stafit sipas departamenteve dhe të siguroj se kërkesat buxhetore lidhur me numrin e të punësuarve të jenë në përputhje me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.	Po		
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Ministri duhet të siguroj që shfrytëzimi i pasurisë është në kuadrin e aktiviteteve të ministrisë, me qëllim të shmangies së saj apo edhe të krijimit të shpenzimeve të pakontrolluara dhe që nuk rrjedhin nga aktivitetet operative të Ministrisë.	Po		
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Ministri të konsideroj formimin e një komisioni për mënyrën se si do të trajtohet kjo çështje, njëkohësisht të siguroj se regjistri i pasurive jep gjendjen reale të saj, në rastet e mungesave të pasurisë të jepen arsyetimet e dokumentuara apo të iniciohet kthimi i saj.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Ministri të siguroj se janë marrë masa shtesë drejt ushtrimit të plotë të kontrollit mbi pasurinë duke krijuar mekanizmat mbi monitorimin dhe raportimin e pasurisë në fund të çdo viti fiskal.		Në proces të zbatimit.	
3.7.2 Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të siguroj se do të rishikohet i tërë procesi i pranimit dhe përcjelljes së faturave për pagesë në mënyrë që të mundësojë menaxhim të drejtë dhe të mbështesë raportimin e plotë të obligimeve të papaguara.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



MINISTRIA E INFRASTRUKTURES

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Infrastruktures për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Nebih Shatri

UD Sekretar i Përgjithshëm, Ministrisë së Infrastruktures

Data: 22.06.17

